



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Datë: 03.07.2026

PROCESVERBAL

**Takimi I (i parë) Publik me qytetarë për punën gjashtëmujore të
Kryetarit dhe ekzekutivit lokal
I mbajtur më 30.06.2026 (e martë)
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Njoftimi për këtë Takim Publik është publikuar më 16.06.2026:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Njoftimi-i-skanuar-shqip.pdf>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Njoftimi-i-skanuar-boshnjakisht.pdf>

Në Facebook-un zyrtar më 16.06.2026:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1BvDc9KhzL/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1E39eF2cr5/>

Pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë gjithsej 28 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 5

2. Meshkuj: 23

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini.

Bexhet Xheladini: *Të nderuar të pranishëm,*

Ju falënderoj që keni gjetur kohë për të marrë pjesë në Takimin e Parë Publik të organizuar me qytetarë. Siç e dini, ne si Komunë jemi të obliguar ligjërisht që brenda një viti t'i mbajmë së paku dy takime publike me qytetarë, ku në pika të përgjithshme mund të raportojmë për ecurinë e punës së organeve të Ekzekutivit lokal dhe kryetarit të Komunës.

Andaj, kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes një pasqyrë të shkurtër për ecurinë e punëve dhe angazhimet që ka pasur Komuna e Dragashit gjatë këtij gjashtëmujori të parë të vitit 2026.

Si rezultat i punës së përbashkët dhe bashkëpunimit të mirë brenda dhe jashtë institucionit, kemi arritur që shumicën e punëve dhe projekteve t'i realizojmë në bazë të Planit të paraparë të Punës.

Puna e Kryetarit, përkatësisht ekzekutivit të Komunës së Dragashit është zhvilluar përmes 8 drejtorive dhe shërbimeve përcjellëse të Komunës, në harmoni me legjislacionin, udhëzimet dhe Statutin e Komunës.

Synimet politike ne qeverisje:

- *Qeverisje të mirë, të përgjithshme, të qëndrueshme, të hapur me qytetarët, demokratike dhe të suksesshme;*
- *Qeverisje me plane dhe shikim kohë e ardhmja;*
- *Qeverisje që gjen zgjidhje, sado sfiduese dhe komplekse të jenë problemet;*
- *Qeverisje me plane të qarta dhe ambicioze;*
- *Qeverisje që përballlet me guxim dhe kryen punë me dinamike të lartë e nuk vonohet;*
- *Qeverisje që vlerëson, motivon dhe mbështet talentin dhe të arriturat e qytetareve tanë të të gjitha shtresave;*
- *Qeverisje ndërtuese që promovon përfshirjen në vendimmarrje të forcave me ndikim në shoqëri, si: forcat politike, Kuvendin e Komunës, bashkësinë fetare, shoqërinë civile, bizneset, individët, të rinjtë dhe grupet e ndryshme të interesit;*
- *Qeverisje energjike që mobilizon resurse dhe përfshinë në veprime investuese e zhvillimore punën në partneritet;*

Qeverisje për të gjithë pa dallim.

Aktivitetet të rëndësishme

(GJASHTËMUJORI I PARË 2026)

- *Qysh në fillim të këtij viti, ashtu siç e dini, jemi ballafaquar edhe një herë me një situatë të vërshtimeve nga reshjet e shumta, të cilat kanë prekur disa vendbanime të Komunës sonë. Andaj, si Komunë, menjëherë kemi filluar angazhimin tonë në shërbim të qytetarëve, ku përveç sanimit të dëmeve në zonat e prekura, Komisioni Komunal menjëherë ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për vlerësimin e dëmeve në infrastrukturë publike, ekonomi familjare, biznese dhe bujqësi. Raporti i Komisionit Komunal është miratuar në Asamblenë Komunale dhe është dërguar në Komisionin Qendror për procedim të mëturjes;*
- *Në fillim të muajit shkurt kemi pritur në takim drejtorin e Zyrës Rajonale të AKP-së në Prizren, me të cilin kemi diskutuar për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe për çështje me rëndësi që lidhen*

me pronat në territorin e Komunës sonë. Jemi dakorduar që ky bashkëpunim të intensifikohet edhe më tej dhe që së shpejti të formalizohet përmes një marrëveshjeje të shkruar;

- *Nga KFOR-i Turk dhe CIMIC-u kemi pranuar një donacion të rëndësishëm me pajisje teknike për shkollën fillore në Restelicë (televizorë, kompjuterë, printerë etj.) të cilat do të kontribuojnë drejtpërdrejt në modernizimin e procesit mësimor dhe në krijimin e një ambienti më funksional për nxënësit dhe stafin arsimor;*
- *Gjithashtu, nga CIMIC-u kemi pranuar edhe një donacion me pajisje teknike për ShFMU “Fetah Sytlejmani” në Dragash, ku përfshihen laptopë, projektorë dhe printerë. Ky donacion ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e infrastrukturës teknologjike të shkollës, duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e procesit mësimor dhe administrativ;*
- *Në bashkëpunim me përfaqësues të Programit Horizon Europe dhe zyrtarë komunalë nga Komuna e Vrapçishtit - Republika e Maqedonisë së Veriut, kemi nënshkruar Memorandumin e Mbështetjes për projektin ndërkombëtar “RURALNEXUS – Inovacioni digjital dhe sipërmarrja ndërkufitare për konkurrueshmëri të qëndrueshme të komuniteteve rurale”, i cili synon zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale përmes inovacionit, bashkëpunimit dhe angazhimit të komunitetit;*
- *Po ashtu, kemi zhvilluar takim me përfaqësuesit e organizatës GIZ, në kuadër të realizimit të Projektit “Aftësim për Punësim” dhe Projektit për Zhvillimin Ekonomik të Grave, ku kemi diskutuar për thellimin e bashkëpunimit në kuadër të këtyre projekteve, me theks të veçantë organizimin e trajnimeve për vetëpunësim të grave. Gjithashtu, kemi shprehur interesimin tonë për mbështetje nga GIZ-i edhe në projekte që lidhen me mbrojtjen e ambientit dhe menaxhimin e mbeturinave, hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe hartave zonale, si dhe mbështetjen për zhvillimin e arsimit dhe pajisjen e shkollave me kabinete të IT-së;*
- *Kemi pritur për një vizitë zyrtare Koordinatorin e ri të Zhvillimit të OKB-së në Kosovë, Stephen O’Malley, me të cilin kemi zhvilluar diskutime lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm lokal, fuqizimin e komuniteteve, mbështetjen për të rinjtë dhe projektet që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve tanë;*
- *Në kuadër të angazhimit tonë për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për qentë endacakë, kemi formuar Komisionin Komunal i cili, në bashkëpunim me organizatën Platform for Lawyers po shqyrton të gjitha hapat dhe procedurat për realizimin e projektit për ndërtimin e një strehimoreje për qentë endacakë në territorin e Komunës së Dragashit;*
- *Në fillim të muajit mars kemi pritur për një vizitë zyrtare një delegacion nga Komuna e Kocaelit – Republika e Turqisë, një ndër komunat më të zhvilluara industriale në Turqi;*
- *Kemi nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit për Projektin “E Ardhmja e Saj – Fuqizimi i Grave Sipërmarrëse në Kosovë”, projekt i cili financohet nga Ministria Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, dhe zbatohet nga OJQ "PREDA Plus", në partneritet me WEntrepreneur dhe me mbështetjen e ASB-së. Ky bashkëpunim synon të mbështesë dhe fuqizojë gratë sipërmarrëse në Komunën tonë përmes zhvillimit të aftësive të tyre në biznes, krijimit të rrjeteve profesionale dhe rritjes së mundësive për pjesëmarrje aktive në ekonominë lokale;*
- *Po ashtu, në muajin mars kemi pritur në takim përfaqësues dhe drejtorë komunalë nga Komuna e Kaçanikut, të cilët kanë shprehur interesim për t’u njohur më nga afër me projektin madhor të njësjellësit të realizuar nga Komuna e Dragashit për 15 fshatra dhe qytezën e Dragashit;*

- Kemi pritur për vizitë edhe Komandantin e ri të Komandës Rajonale Perëndim të KFOR-it, Kolonelin Federico Mora, të cilin e kemi njoftuar me zhvillimet aktuale në Komunë dhe kemi shprehur mirënjohjen tonë për angazhimin dhe kontributin e vazhdueshëm të KFOR-it në Kosovë, duke theksuar në veçanti mbështetjen e pakursyer të CIMIC-ut dhe LMT-së për institucionet lokale të Komunës sonë;
- Në kuadër të angazhimit tonë për rritjen e transparencës komunale dhe përmbushjen e obligimeve që dalin nga Agjenda Evropiane, kemi hartuar dhe miratuar në Kuvendin e Komunës Strategjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030;
- Në fillim të muajit prill Komunën tonë e ka vizituar edhe në takim Ambasadori i Gjermanisë, Shkëlqesinë e Tij, z. Rainer Rudolph, së bashku me përfaqësues nga menaxhmenti i lartë të GIZ-it, me të cilët kemi zhvilluar një bisedë konstruktive lidhur me gjendjen aktuale dhe sfidat kryesore me të cilat përballlet Komuna E Dragashit. Gjithashtu, së bashku kemi vizituar hapësirat e organizatës “AVOKO”, ku kemi parë nga afër implementimin e projekteve dhe rezultatet konkrete të bashkëpunimit me komunitetin lokal;
- Kemi formuar Komisionin për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, të përbërë nga 27 anëtarë, ku bëjnë pjesë përfaqësues nga Komuna e Dragashit, kompania fituese për hartimin e PZhK-së, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Parku Nacional, ekspertë të jashtëm, si dhe përfaqësues të organizatave lokale dhe ndërkombëtare. Në prill, Komisioni ka mbajtur Takimin e parë konsultativ dhe informues për ecurinë e hartimit të PZhK-së, dokumentit më të rëndësishëm strategjik, i cili do të përcaktojë drejtimin e zhvillimit ekonomik, hapësinor dhe mjedisor të Dragashit për vitet në vijim;
- Në kuadër të angazhimit tonë në fushën e shëndetësisë, përmes stafit profesionist të QKMF-së kemi vazhduar me vitin e tretë radhazi me Progrmain e vizitave sistematike shëndetësore për nxënësit e shkollave të Komunës së Dragashit;
- Siç e dini, Komuna jonë edhe këtë vit ka fituar Grantin e Performancës Komunale, vlera e të cilit është 883,837.56 euro. Pas njoftimit nga Ministria, me Bordin e Drejtorëve dhe inxhinierët komunalë menjëherë kemi filluar planifikimin e shpenzimit të këtyre mjeteve dhe procedurat e përgatitjes dhe dorëzimit të projekteve në MAPL. Projektet që do të financohen nga ky Grant përfshijnë investime në infrastrukturë rrugore, ndriçim publik, mure mbrojtëse, deponi të mbetjeve inerte, objekte sportive dhe infrastrukturë shkollore;
- Në kuadër të planifikimeve buxhetore për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028-2029, kemi organizuar dy dëgjime buxhetore me qytetarë dhe grupe të interesit për Draftin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029, ku kemi marrë kërkesat dhe propozimet e tyre. Pas këtij procesi të konsultimit me publikun, KAB-i është miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e pestë të rregullt, të mbajtur më 25.06.2026, sipas afateve të përcaktuara ligjore;
- Në fillim të muajit qershor kemi filluar testimin e Impiantit për përpunimin e ujërave të zeza në fshatin Breznë, një projekt i rëndësishëm i cili do të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e burimeve ujore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, duke siguruar një ambient më të pastër dhe më të shëndetshëm në zonën turistike të liqenit të Breznës;
- Po këtë muaj, Komunën tonë e ka vizituar edhe Ambasadori i Republikës së Sllovenisë në Kosovë, z. Borut Blaj, i shoqëruar nga përfaqësues të Projektit “Të Drejtat tona” nga Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU). Me këtë rast, është mbajtur edhe ceremonia solemne e ndarjes së certifikatave për

mësimdhënësit dhe trajnerët që kanë përfunduar me sukses trajnimet në kuadër të këtij projekti. Përmes kësaj nisme janë trajnuar rreth 90 mësimdhënës nga komunitete të ndryshme;

- Për nder të Ditës së Çlirimit të Komunës së Dragashit, edhe këtë vit, ashtu siç e kemi bërë tashmë traditë, kemi nderuar me mirënjohje dhe dhurata simbolike pensionistët e arsimit, shëndetësisë dhe administratës komunale, si shprehje e respektit dhe falënderimit për gratë dhe burrat që për dekada të tëra i kanë shërbyer me përkushtim komunitetit tonë;*
- Së bashku me organizatën Ec Ma Ndryshe kemi filluar zbatimin e Projektit ‘Inventarizimi i Shërbimeve Administrative Komunale’, i mbështetur nga GIZ dhe i zbatuar nga organizata EC Ma Ndryshe, në partneritet me Syrin e Vizionit. Qëllimi kryesor i këtij projekti është inventarizimi i plotë i shërbimeve administrative komunale. Kjo do të mundësojë që komuna t'i ketë të gjitha shërbimet e saj të evidentuara, të standardizuara dhe të dokumentuara në një vend të vetëm;*
- Në kuadër të angazhimit dhe përkushtimit tonë për të drejtat e grave dhe fëmijëve, kemi nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me Qendrën për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Rajonin e Prizrenit. Ky memorandum synon sigurimin e mbështetjes së qëndrueshme financiare për funksionimin e rregullt të qendrës, me qëllim ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve të strehimit dhe mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre;*
- Sa u përket organizimit të ceremonive zyrtare për festa shtetërore dhe kombëtare, kemi thirrur seanca dhe akademi solemne për nder të 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë; për nder të Epopesë së UÇK-së (5,6 dhe 7 mars); për nder të 5 Majit - Ditës së Dëshmorëve; dhe për nder të 12 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Dragashit;*
- Gjithashtu, në kuadër të agjendave të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, së bashku me OJQ-të partnere kemi organizuar aktivitete të ndryshme si: koncerte dhe programe festive, turne në futboll dhe volejboll, manifestimin kulturor dhe letrar “Sofra e Ymer Prizrenit” në Zgatar, Garat e Vrapimit të Kuajve dhe Garat e Pehlivanëve, Mitingun e Motogrosit, Garat e Çiklizmit etj.;*
- Në Gjashtëmujorin e parë 2026, nga subvencionet në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë përfituar gjithsej **12 OJQ, me një shumë totale prej 91,500 euro;***
- Aktualisht është në proces të vlerësimit edhe Thirrja publike për financimin e OJQ-ve të cilat do të merren me organizimin e Festivalit Ballkanik “Opoja Vallëzon” dhe manifestimet kulturore për Ditët e Mërgatës në Opojë dhe Gorë;*
- Sa u përket investimeve kapitale, gjatë kësaj periudhe raportuese kemi nënshkruar **18 kontrata për projekte të ndryshme, me një vlerë totale 1,016,191€;***

Investimet Kapitale

Komuna e Dragashit përgjatë gjysmës së parë të vitit 2026 e ka realizuar në masë të konsiderueshme Planin e Prokurimit. Kemi nënshkruar gjithsej mbi 18 kontrata për realizimin e projekteve të ndryshme nëpër të gjithë territorin e Komunës sonë, të cilat lidhen kryesisht me modernizimin e infrastrukturës publike nëpër institucione shëndetësore dhe arsimore, kubëzimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale, ndërtimin e infrastrukturës sportive, furnizim dhe shërbime etj. Vlen të përmendet se njëri ndër projektet më të kushtueshme dhe më të rëndësishme kapitale i cili është realizuar gjatë kësaj periudhe raportuese është Impianti për Përpunimin e Ujërave të Zeza në fshatin Brezëne.

Projektet në realizim e sipër – 2026

077-Hartimi i planit zhvillimor Komunal 2025-2035- Dragash	150,000.00
006-Ndërtimi I kanalizimit dhe kubëzimi në rrugën Brezne-Likeni në fshatin Brezne (projekt dy vjeçar) “ Ri-tenderim	496,712.27
007-Kubëzimi në rrugën Qendra në fshatin Buzez-(projekt dy vjeçar)	110,000.00
008-Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në vendin Studenec dhe Bevrivec në fshatin Kërstec	40,000.00
011-Ndërtimi i murit mbrojtës (Peterce),kubëzimi (qendrës së fshatit Radesha e Eperme) dhe vendosja e mbrojtësve elastikë në rrugën për në Radeshe –(projekt dy vjeçar)-Ri tenderim	140,000.00
012-Ndërtimi i shtëpisë malore turistike në fshatin Krushevë-Projekt dy vjeçar	55,000.00
013-Kubëzimi i rrugëve në rrugët Adem Berisha,Beteja e Buçes dhe Qerza në fshatin Buçe- (projekt dy vjeçar)	160,000.00
014-Ndërtimi I rrjetit te ujësjellesit në qendër të fshatit Brod-(projekt dy vjeçar)	33,000.00
015-Ndërtimi i murit mbrojtës dhe kubëzimi në fshatin Gllaboçicë	70,000.00
016-Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi I murit mbrojtës në fshatin Mlik	25,000.00
017-Kubëzimi i rrugëve në fshatin Bresanë- (projekt dy vjeçar)	150,000.00
018-Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi I ujësjellësit në rrugën Kajqovce në fshatin Libevisht	18,000.00

Projektet në realizim e sipër nga viti 2025

Shajne - Kubezimi
Kuk- Ndertimi I Ures
Ndertimi I Impinatit Brezne
Bellobrad- Ndertimi I rezervuarit mbi Zabel, Kubezimi
Ndertimi I Stadiuimit BLAQ
Mirmbajtja e Ndriqimit ne territorin e Komunes
Kubezimi I rrugeve, ndertimi I mureve mbrojtës ZYM, QOLLOPEK
Instalimi I rrymes ne impiantin ne Radesh
Ndertimi I shtëpise malore ne BROD
Ndertimi I Nyjeve Sanitare ne gjimnazin e Drgashtit (Aneksi)
Ndertimi I stadiumit ne fsh.Pllave
Ndertimi I infrastrukturees ne fsh.Pllajnik

Ndertimi i stadiumit në Restelicë
Rregullimi i Prroit ne Krusheve
Ndertimi i stadiumit ne Lubovishte
Rregullimi i infrastruktures ne Rrugen "Qupina" ne Brod

Projektet e përfunduara në vitin 2026

KUK- kubezimi
Kubezimi I rrugeve dhe ndertimi I murit mborjtes ne ZAPLLUXHE
Ndertimi I ujembledhsave ne fshatin KUK
Ndriqimi Publik ne fsh.KUKLIBEG
Ndriqimi Publik ne fsh.PLLAVË
Riparimi I rrugës se bjeshkës në pjesën e dëmtuar në fshatin Bresanë
Riparimi I rrugës së bjeshkës në pjesën e dëmtuar në fshatin Pllajnik

Renovimi I QMF dhe AMF ne fsh.Gores
Ndertimi I trotuareve ne r.Opojes (Bello-Brrut, Bresane - Zaplluxhe)
Kubezimi I rrugeve ne fshatin BRRUT
Kubezimi ne fshatin Restelice

Subvencionet për projekte kulturore, rinore dhe sportive

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, Komuna e Dragashit ka mbështetur financiarisht OJQ të ndryshme për organizimin e aktiviteteve të shumta në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Shuma e përgjithshme e mbështetjes financiare për këto projekte ka qenë 91,500 euro.

Nr.	Emri i OJQ-së	Emri i projektit	Shuma
NË FUSHËN E SPORTIT			
1.	KLUBI I KUAJVE "OPOJA"		14.000€
2.	SHKOLLA E FUTBOLLIT "FC DRAGASH"		6.000€
3.	SHKOLLA E FUTBOLLIT "AROMA"		6.000€
4.	KLUBI I FUTBOLLIT "OPOJA"		30.000€
5.	KLUB SPORT "SHARRI"		5.000€
6.	KLUBI I SKITARISË "ARXHENA"		2.500€
7.	KLUBI I MOTORRISTËVE "ENDURO SHARRI"		7.500€
8.	KLUBI I ÇIKLIZMIT "OPOJA"		1.500€

9.	KLUBI I BASKETBOLLIT "SHARRI"		1.000€
10.	KLUBI I SHAHUT "OPOJA"		3.500€
Gjithsejtë në fushën e sportit:			77.000€
NË FUSHËN E KULTURËS			
1.	OJQ "KROI I MACES"		3.500€
9.	SHKA "BRESANA" BRESANË		11.000€
Gjithsejtë në fushën e kulturës:			14.500€
SHUMA E PËRGJITHSHME E SUBVENCIONEVE NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË E SPORTIT:			91.500€

PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

Gjatë periudhës raportuese për gjysmën e vitit 2026, Komuna e Dragashit ka zhvilluar aktivitete të rregullta të konsultimeve publike, përfshirë **konsultime publike dhe dëgjime buxhetore**, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar **dy dëgjime buxhetore** për Draftin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Gjithashtu janë mbajtur edhe dy konsultime publike lidhur me drafte të dokumenteve të rëndësishme të politikave lokale, si Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026-2030, dhe Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave. Në këto takime, Komuna e Dragashit ka synuar pjesëmarrjen sa më të gjerë të qytetarëve, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe grupeve të ndryshme të interesit, me qëllim të përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse dhe planifikuese të Komunës.

Lloji i konsultimit	Nr. total i pjesëmarrësve	Gra	Burra
KONSULTIME PUBLIKE	41	4	37
DËGJIMET BUXHETORE	35	0	35
Totali:	76	4	72

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Transparenca dhe llogaridhënia mbeten ndër shtyllat kryesore të qeverisjes së mirë lokale. Në këtë kuadër, Komuna ka trajtuar me prioritet të veçantë zbatimin e legjislacionit në fuqi për qasje në dokumente publike, duke garantuar të drejtën e çdo qytetari për informim të plotë, të saktë dhe në kohë.

Gjatë vitit raportuese, administrata komunale ka siguruar trajtimin efikas të kërkesave për qasje në dokumente publike, në përputhje me afatet ligjore dhe standardet e transparencës institucionale. Përmes bashkëpunimit ndërmjet drejtorive komunale dhe Zyrës për Informim, është mundësuar shqyrtimi profesional i çdo kërkesë, duke respektuar njëkohësisht parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.

Të Dhënat Lidhur me Kërkesat për Qasje në Dokumente Publike

Numri i kërkesave të pranuar			
Numri total i kërkesave janar/qershor 2026	Kërkesat e aprovuara plotësisht	Kërkesat e aprovuara pjesërisht	Kërkesat e refuzuara
27	27	0	0

Profili i Aplikuesve dhe Dokumentet e Kërkuara			
Profili	Numri i kërkesave	Dokumenti	Numri i kërkesave
Mediume	2		
OJQ	2	Shpenzim i parasë publike	0
Individë	23	Dokumente administrative	3
Të tjerë	0	Statistika	1
		Dokumente lidhur me marrëdhënien e punësimit	23

SEKTORI LIGJOR

Zyra Ligjore, në kuadër të ushtrimit të përgjegjësiave dhe autorizimeve të saj, si dhe në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, për periudhën **janar – qershor 2026**, është angazhuar në ofrimin e ndihmës juridike, shërbimeve dhe këshillimeve ligjore, si dhe në harmonizimin, plotësimin, ndryshimin dhe hartimin e akteve nënligjore të propozuara nga Kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës dhe Drejtoritë Komunale në Komunën e Dragashit.

Për periudhën **janar – qershor 2026**, në këtë sektor është bërë:

- Udhëheqja e procedurave administrative sipas lëndëve përkatëse;
- Ofrimi i këshillave dhe opinioneve ligjore për Kryetarin e Komunës, Kuvendin e Komunës, Drejtoritë Komunale, sektorët dhe njësitë organizative;
- Hartimi dhe harmonizimi i rregulloreve dhe akteve juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë vendime, urdhëresa, marrëveshje dhe shkresa përcjellëse për Kryetarin, Kuvendin dhe Drejtorët e Drejtorive;
- Pjesëmarrja në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështje të caktuara;
- Pjesëmarrja në të gjitha seancat e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës;
- Kryerja e veprimeve në mënyrë të vazhdueshme dhe permanente;
- Arkivimi dhe sistemimi i dokumenteve të Zyrës Ligjore, si dhe përcjellja e vazhdueshme e ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve të nxjerra nga institucionet qendrore;
- Realizimi i objektivave të planifikuara për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026.

OBJEKTIVAT E ARRITURA

Zyra Ligjore gjatë kësaj periudhe ka dhënë kontribut të rëndësishëm në fushën e këshillimit dhe dhënies së opinioneve ligjore për të gjitha nevojat e administratës komunale, duke përfshirë edhe Kuvendin e Komunës.

Në vijim paraqiten aktet e hartuara nga Sektori Ligjor:

Nr.	Përshkrimi i lëndëve	
	Mjetet e lejuara nga Subvencionet e Zyrës së Kryetarit	Numri i lëndëve
1	Vendime për mjete për botim libri	3
2	Vendime mjete për OJQ	5
3	Vendime për mjete për familjarët e dëshmorëve	2 (3 anëtarë)
4	Vendime për mjete për familjarët e veteranëve të UÇK-së	1 (3 familje)
5	Vendime për mjete për personat me nevoja të veçanta	2 (8 anëtarë)
	Total nr. i vendimeve	13

Nr.	Mjetet e lejuara nga pozicionet tjera	Numri i lëndëve
1	Vendime për mjete për dreka zyrtare	15
2	Vendime për sigurimin e mjeteve për kartela –mbushje telefonik	11
3	Vendime për lejin e mjeteve për mediat	15
4	Vendime për lejin e mjeteve për derivate	8
5	Vendim për pagesën e kronit publik	1
	Totali i vendimeve	50

Nr.	Lëndët e ndryshme	Numri i lëndëve
1	Autorizime	1
2	Marrëveshje bashkëpunimi dhe mirëkuptimi për bashkëfinancim	4 (të parrealizuara)
3	Memorandume bashkëpunimi dhe mirëkuptimi	3 (të parrealizuara)
4	Kontrata	12
5	Kontrata për punë	1
6	Aneks kontratë për shërbime postare	1
7	Njoftime	2
8	Njoftim për diskutim publik	2
9	Njoftim për takime publike	1
10	Kalendar i dëgjimeve buxhetore (KAB 2027-2029)	1
11	Plane të Punës	8
12	Raporte të Punës	7
13	Raporte 6 mujore të auditimit	1
14	Raport vjetor i auditimit	1
15	Dërgimi i lëndëve të vërsimeve në MAPL	2
16	Letër konfirmimi, referencë dhe mbështetje	2
17	Konfirmime	2
18	Raportim për performancë i Grupit Punues	1
29	Planifikimi buxhetor për vitin 2026	1
Totali i lëndëve		52

Nr.	Kërkesat e Kryetarit të Komunës drejtuar Ministrive dhe Organizatave tjera	Numri i lëndëve
1	Kërkesë për zgjerimin dhe zhvillimin e aktivitetëve afariste – për KFOR-in Turk	1
2	Kërkesë për hapjen e rrugës në hyrje të fshatit Kukajan – për KFOR-in Turk	1
3	Kërkesë për hapjen e rrugës në vendin e quajtur BRIZA në fshatin Kapre – për KFOR-in Turk	1
4	Dërgimi i lëndëve të vërsimeve – për MMPHI Prishtinë	1
5	Dërgimi i lëndëve të vërsimeve – për MPB, Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave Prishtinë	1
6	Letër referencë për OJQ “AVOKO” – Dragash	1
7	Ankesë lidhur me vlerësimin e gabuar të treguesve të performancës komunale të Komunës së Dragashit – për Komisionin e Ankesave të Performancës Komunale në MAPL	1
8	Kërkesë për leje kalimi kufitar për Bashkinë e Kukësit	1
Total		8

Nr.	Kërkesat e ndryshme	Numri i lëndëve
1	Kërkesa MAPL-së dhe Drejtorisë së Thesarit	29
2	Formular për barazim mujor Ministra e Financave	8

3	Njoftime	1
4	Pyetësor i vlerësimit Ministria e Financave	1
5	Raport vjetor i progresit fizik e financiar	4
6	Kërkesa për rekrutim – punësim	12
	Total	55

Nr.	Vendimet e Zyrës së Prokurimit	Numri i lëndëve
1	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës	10
2	Vendim për caktimin e ekipit për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës	17
3	Vendim për themelimin e komisionit për pranimin teknik të punimeve	16
4	Vendim për shpalljen e tenderëve	25
5	Vendim për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave për punime shtesë	5
6	Ankand publik	1
7	Vendim për vlerësim të kontratave	2
	Total lëndët e prokurimit	76

PËRMBYLLJE

Gjashtëmujori i parë i këtij viti është karakterizuar nga një angazhim i vazhdueshëm në realizimin e objektivave strategjike të Komunës, në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe në forcimin e qeverisjes së mirë. Përmes planifikimit të kujdesshëm, menaxhimit të përgjegjshëm financiar dhe koordinimit ndërinstitucional, është arritur progres i dukshëm në disa fusha kyçe të zhvillimit lokal. Përkushtimi institucional mbetet i orientuar drejt rritjes së efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies, si dhe drejt krijimit të kushteve më të mira për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social.

Ky raport shërben si bazë për planifikimin e mëtejshëm dhe për avancimin e prioritetëve zhvillimore të Komunës në vitin pasues.

Prioritetet tona kryesore për Dragashin vazhdojnë të jenë:

- *Administratë efektive, e përgjithshme dhe me shërbime moderne;*
- *Organizim më i mirë i punës dhe efikasitet i plotë i administratës së Komunës;*
- *Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit;*
- *Realizim i planit të të hyrave të Komunës;*
- *Rritja e përkrahjes për bujqësinë dhe për fermerët;*
- *Zhvillimi i turizmit dhe ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse;*
- *Nxirje të investimeve dhe projekteve në turizëm;*

- *Trotuare dhe shtigje të ecjes për këmbësorë dhe biçiklistë;*
- *Investime për ndriçim publik;*
- *Kritje e cilësisë dhe investime në arsim;*
- *Investime në nyje sanitare dhe meremetim të shkollave;*
- *Bursa për studentë;*
- *Hartimi i PZhK-së dhe Hartës Zonale;*
- *Terrene të reja sportive dhe përkrahje e sportit, aktivitete të planifikuara me të rinjtë;*
- *Krijimi i kushteve të përshtatshme për investime të drejtpërdrejta për të mirën e qytetareve përmes krijimit të vendeve të përbërshme të punës si dhe zhvillimit ekonomik;*
- *Bashkëpunimi me komunitetin fetar, shoqëritë civile OJQ ndërkombëtare, vendore dhe partner të tjerë.*

Faleminderit për durimin tuaj! A do dikush prej pjesëmarrësve që ta marrë fjalën, nëse keni ndonjë vërejtje vërejtje ose sugjerim?

Riza Hodža, banor i fshatit Restelicë: Projekti për lagjen Lokuf është miratuar para dy vitesh, por ende nuk ka filluar asnjë punim për shtrimin e rrugës me kubëza. Çfarë ka ndodhur me këtë projekt? Aty janë ndërtuar dy shtëpi dhe pritjet të ndërtohen edhe të tjera.

Vetim Ramadan, nënkryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket pyetjes tuaj, i nderuar, nga viti i kaluar ka qenë një projekt sa i përket kubëzimit të rrugëve në fshatin Restelicë. Ai projekt ka qenë deri në gjysmën e parë të këtij viti, mirëpo sasisë janë harxhuar vitin e kaluar. Këtë vit ka mbetur një pjesë e vogël. Por gjithashtu, pjesa tjetër e mbetur e rrugëve që janë të papërfunduara, e që ka shumë në fshatin Restelicë, janë në projektin e ri i cili është duke u përgatitur nga Zyra e Prokurimit dhe Urbanizmit, dhe shumë shpejt fillojnë procedurat sa u përket të gjitha rrugëve që janë, sidomos në pjesën e zgjeruar – edhe tek lagja juaj Llokov, po edhe në pjesën tjetër që është në lagjen e re që i thonë tash, në Restelicë. Kështu që, nuk ka nevojë për asnjë shqetësim, gjithë ky projekt i kubëzimit do të përfundohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Duhet pak durim, meqenëse po kemi telashe edhe sa u përket kompanive që ofertojnë në fshatin Restelicë, sepse ka vështirësi të dërgimit të materialit deri në pjesët më të sipërme. Por, në tërësi projekti i kubëzimit do të përfundojë. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Pjesën më të madhe të përgjigjes e dha nënkryetari. Janë të parapara edhe 200 mijë euro për rregullimin e infrastrukturës në fshatin Restelicë. Edhe sigurisht që, projektet të cilat kanë mbet pa përfunduar, do të përfundojnë me këto mjete që i kemi paraparë ne si Kuvend Komunal.

Alija Čufta, banor i fshatit Restelicë: Të nderuar të pranishëm, vetëm shkurtimisht. Kemi një problem. Në rrugën Restelicë–Krushevë ndodhet një kthesë që ende nuk është rregulluar. Kërkojmë që kjo kthesë të rregullohet sa më shpejt, në mënyrë që të shmanget ndonjë aksident. Çdo ditë nëpër atë rrugë kalojnë shumë njerëz dhe ajo kthesë është në gjendje shumë të keqe. Mund të shkaktojë probleme serioze.

Bexhet Xheladini: Faleminderit për pyetjen! Sa i përket kërkesës që ke bërë, është shumë e arsyeshme. Aty ka pas çdo herë edhe ndeshje komunikacioni. Kjo pjesë e rrugës është pjesë që nuk është në kompetencë të Komunës, por është në kompetencë të Ministrisë së Infrastrukturës. Me sa kemi ne informata, Ministria ka qenë në vend të ngjarjes, i ka bërë matjet dhe është duke e përgatit projektin. Besojmë që këtë vit ata do të fillojnë ta rregullojnë atë pjesë që është shumë problematike. Është edhe një gjë, që Ministria e Infrastrukturës për çdo vit ndan mjete – gati nga 2 milionë euro – për rrugën Dragash-Resticë. Ato mjete çdo herë i çon ne suficit. I ndan mjetet, nuk i realizon projektet fare, nuk i qet tenderët, vitin e ardhshëm prapë e bën një gjë të tillë. Ishalla këtë vit, mjetet që i ka paraprë për me e rehabilitue këtë rrugë, nuk i çon në suficit, por i realizon përmes projekteve që janë të parapara.

A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë këtu po i shoh edhe drejtorët, edhe nënkryetarët. Nëse në këtë Raport nuk e kemi përmend ndonjë gjë apo ndonjë projekt, ju kisha lut që me shkrim t'ia dërgoni Fariut, në mënyrë që në raportin e ardhshëm t'i inkorporojmë. Atëherë, nëse nuk ka edhe dikush tjetër me e marrë fjalën, ju falënderoj shumë për pjesëmarrjet tuaj dhe e mbyllim këtë takim!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e takimit publik, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: [https:// dragash.rks-gov.net/ news/ u-mbajt-takimi-i-pare-publik-me-qytetare/](https://dragash.rks-gov.net/news/u-mbajt-takimi-i-pare-publik-me-qytetare/)

Boshnjakisht: [https:// dragash.rks-gov.net/ sr/ news/ danas-je-odrzan-prvi-javni-sastanak-sa-gradjanima/](https://dragash.rks-gov.net/sr/news/danas-je-odrzan-prvi-javni-sastanak-sa-gradjanima/)

Në Facebook:

Shqip: [https:// www.facebook.com/ share/ p/ 18RnJiXqYq/](https://www.facebook.com/share/p/18RnJiXqYq/)

Boshnjakisht: [https:// www.facebook.com/ share/ p/ 1JWK1S3PFJ/](https://www.facebook.com/share/p/1JWK1S3PFJ/)

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 020/01-11772/26/1
30.06.2026
Dragash - Dragaš



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 30.06.2026

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE TAKIMIN I (E PARË) PUBLIK ME
QYTETARË PËR PUNËN E GJASHTË MUJORIT TË PARË TË VITIT
2026

LISTA UÇESNIKA PRVOM JAVNOM SASTANKU SA GRAĐANIMA O
RADU U PRVOJ POLOVINI 2026 GODINE

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Etnia Etnička pripadnost	M	F	Nënshkrimi
Br.	Ime i Prezime	Prebivalište		M	Ž	Potpis
1	SHAD TOSUNI	RAPCA	BOŠNJAK	M		
2	Bashkim Dauti	Kosovë	Shqiptar	M		
3	Radio Ramis	Kestel	BOŠNJAK	M		
4	FINIM SPAHIU	DRAGASH	SHQIPTAR	M		
5	SIRHAN BEJTAJ	Brat	BOŠNJAK	M		
6	Sam Shkenderi	Brat	BOŠNJAK	M		
7	JHARR BAHTIJARI	BELLOBRAD	SHQIPTAR	M		
8	ARJETA QOLLOKU	24M	SHQIPTAR		F	
9	Zaide Veseli	Bresanë	Shqiptar		F	
10	Ela Qafleshi	BELLOBRAD	SHQIPTAR		F	
11	Teuta Gashi - Shqetia	Brezne	Shqiptar		F	
12	Faton Jafaj	Brat	Shqiptar	X		
13	EDISON BECIRI	PRIZREN	GOSAN	M		
14	CHES GASHI	RR	GODAN	M		
15	Leid Ismaili	Rapq	GOSAN	M		
16	Dreni Myrtezani	Zaplluxhe	SHQIPTAR	M		
17	Beon Hoxhason	BROJ	Bosnjak	M		
18	ARUT KACANDEMI	KOSANË	Shqiptar	M		
19	Veton Halili	Zaplluxhe	Shqiptar	M		
20	Zeni Krasniqi	Buge	Shqiptar	M		
21	Anjeta Sherafi	Brene	Shqiptar		F	
22	RAISA SABANI - JETEMI	Rapca	GODAN		F	
23	Fati KALONI	Kosovë	Shqiptar	X		
24	Uro Zogaj	BRESAN	SHQIPTAR	M		
25	Edon BASHIRI	ZAPLLUXHE	Shqiptar	M		
26	REHAT ALIJA	BLAC	SHQIPTAR	M		

27	Artan	Lodj	Skripten	M		Stuf
28						
29	Hodza Riza	Gornac	X			X/P.
30						
31						
32						
33						
34						
35						
36						
37						
38						
39						
40						
41						
42						
43						
44						
45						
46						
47						
48						
49						
50						
51						
52						
53						
54						
55						
56						
57						
58						
59						
60						
61						
62						
63						
64						
65						
66						
67						
68						
69						
70						



